



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 628/10 Prot.

Tiranë, më 23.04.2021

VENDIM
Nr. 68, datë 23.04.2021

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË MBARËVAJTJES SË VEPRIMTARISË
DHE TË MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT**

Në zbatim të neneve 38 (pika 1, germa "i"), 46 (pika 3) të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH", të neneve 20 (germa "n"), 26 (pika 3, germa "c") të Statutit të UST- së, në nenin 10 të Rregullores së UST-së, Senati Akademik i UST-së në mbledhjen e dates 23.04.2021,

VENDOSI:

1. Të ngrihet komisioni i përhershëm institucional, KOMISIONI I MBARËVAJTJES SË VEPRIMTARISË DHE TË MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT, në Universitetin e Sporteve të Tiranës me këtë përbërje:
 - 1(një) anëtar, i cili vjen nga rradhët e studentëve;
 - 1(një) anëtar, i cili vjen nga rradhët e punonjësve ndihmësakademikë të drejtorisë që mbulon marrëdhëniet me studentët, Alumni-n dhe koordinimin dhe komunikimin;
 - Me nga 1(një) anëtar përfaqësohen njësitë kryesore që ofrojnë programe studimi (fakultetet).
2. Të hapë thirrjen për vetëkandidimin e personelit akademik, ndihmësakademik si dhe anëtarit student për këtë komision.
3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF.DR. AGRON KASA

